

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. Prot. Br Prot. Prot No.	03-3084/12
Nr. l faq. Uroj stranica Nr. pages	02
Data Datum Date	03.09.2012
PRISHTINE	

**GJL. Nr.940/2012**

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Avdullah Isufi nga fsh.Lloshkobare Komuna e Ferizajt, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24883/11 të dt. 29.12.2011, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 15.08.2012, mori

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** ankesa e paraqitur si e **PABAZUAR**  
**VËRTETOHET** aktvendimi i goditur si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.  
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24883/11 të dt.29.12.2011, ka shpallë përgjegjës të pandehurin Avdullah Isufi nga fsh.Lloshkobare Komuna e Ferizajt, sepse më dt.24.02.2011, si këshilltar politik i zëvendësministrit në Ministrinë e Bujqësisë e ka pranuar formularin për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, por këtë obligim nuk e ka përmbushur brenda afatit ligjor, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 400 Euro. Me te njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Avdullah Isufi, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtësve, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin e shqiptuar, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se nuk e ka ditur se për sa kohë do ta ushtroi atë pozitë e që ka reflektuar duke mos e plotësuar formularin, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ose të ndryshohet e ai të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarimin e dhënë të pandehurit në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.12.10.2011, i cili e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e pabazuar.

Nga provat e deponuara dhe të administruara nga Gjykata e shkallës së parë, pa dyshim është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri e ka kryer veprën kundërvajtëse, për të cilën e mbanë përgjegjësinë kundërvajtëse, meqë i pandehuri në mbrojtjen e tij në procesverbal të marrjes në pyetje e ka pranuar kundërvajtjen që me kërkesë për fillim të procedurës kundërvajtëse i është vu në barrë në tërësi dhe kjartë, se nuk ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në AKK, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2011, por pas disa muajve

03-3084/12/02  
Skuz

më dt.13.10.2011, pra pas inicimit të procedurës kundërvajtëse me arsyetim se nuk e ka ditur se për sa kohë do ta ushtroi atë pozitë. Andaj gjykata e shkallës së parë ka pasur bazë për konkludim që i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen nga dispozita e aplikuar, ashtu që thëniet që tash i përsëritë në ankesë, nuk janë të asaj natyre që do ta vënin në dyshim rregullsinë e konstatimit të fakteve dhe as tipareve juridike të veprës, andaj nuk ka bazë për ndryshimin e aktvendimit të goditur siç ka propozuar i pandehuri në ankesën e paraqitur.

Kolegji vlerëson se Gjukata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe e cila do të ishte ose ka mund të jetë me ndikim për vendosje, përkatësisht aplikim të gabuar të drejtës materiale në dëm të pandehurit, kurse dënimi shqiptuar të pandehurit konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, veprës së kryer dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra dhe dënimi i shqiptuar nuk është i ashpër, se për veprën kundërvajtëse për të cilën është shpall përgjegjës i pandehuri është dënimi me gjobë të përcaktuar në shumë prej 300 deri në 1000 Euro dhe ky dënim i shqiptuar është afër minimumit ligjor, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për zbutjen e dënimit të shqiptuar.

Me sa u tha me larte konform nenit 220 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv .

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**GJL. Nr. 940/2012 të dt. 15.08.2012.**

**SEK. JURIDIKE**  
Sanije Salihu



**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
Ramiz Kuqi